

## Tregu i telekomunikimeve

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Telekomunikacion Nr.2002/7, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-085, janë krijuar kushtet për liberalizimin e tregut të telekomunikimeve në Kosovë .

Ndërkaq, Rregullorja e ART për 'Të drejtën për shteg dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës' po inkurajon shfrytëzimin më efikas dhe më ekonomik të infrastrukturës ekzistuese telekomunikuese dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.

Në përkrahje të këtyre iniciativave, KOSTT-i është angazhuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fiber optike.

Si rezultat i angazhimit, në fund të vitit 2013, KOSTT-it iu lëshua Autorizimi / licenca për Operimin e shërbimeve të infrastrukturës, nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ARKEP.



Si kompani, ne nuk jemi duke u përpjekur për të ndryshuar botën - gjithë çka ne duam është që për operatorët e licencuar ta bëjmë më të lehtë dhe më të lirë ofrimin e shërbimeve "broadband", për bizneset e Kosovës dhe për qytetarët e saj.

## Roli ynë në tregun e telekomunikimeve

Sipas Rexhimit të Autorizimit të Përgjithëshëm, në përputhje me dispozitat e Nenit 16 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe Rregullores Nr.25 për Autorizimet e Përgjithëshme (ref. ARKEP nr. prot.015/B/14) dhe Vendimit Nr.581 (ref. ARKEP nr. prot. 002/B/15), KOSTT tani është regjistruar në Regjistrin e Ndërmarrjeve për:

**Ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike**



## Cili është objektivi ynë ?

Kompania jonë është e pozicionuar në mënyrë unike, si ofrues i rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, duke ofruar një qasje të hapur për klientët në mundësitë e mëdha komunikuese.

Me operimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, KOSTT-i është duke u përpjekur të transformoj industrinë e telekomunikimeve të Kosovës, duke stimuluar konkurrencën, reduktimin e kostove të "bandwidth"-it dhe për të përmirësuar pozitën e "broadband"-it në Kosovë.

Objektivi ynë është që të sigurojmë shërbime publike të komunikimeve elektronike në një shkallë më të gjere dhe ne do të angazhohemi që të:

- Zbatojmë dhe menaxhojmë me kosto-efektive lidhjet e rrjetit fibër optik, në mënyrë të hapur dhe të barabartë për të gjithë konsumatorët;
- Rrisim tregun e produkteve dhe shërbimeve të bazuar në fibra optik, brenda rajoneve të ndryshme te vendit;
- Të kontribuojmë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme të Kosovës, përmes ofrimit të hapur të shërbimeve moderne telekomunikuese, me çmime të vulltshme.
- Per Operatorët ta bëjmë më të lehtë dhe me kosto më të ulët ofrimin e shërbimeve "broadband" dhe shërbimeve tjera telekomunikuese, njekohesisht duke ju mundësuar rritjen e numrit të konsumatorëve.
- Të ofrojmë shërbime profesionale për klientët tanë;

## Cilat janë shërbimet që ofrojmë ?

### • Bashkëshfrytëzimi i infrastrukturës

KOSTT mund të bashkëshfrytëzojë infrastrukturën e vetë aktuale me operatorët e telekomit. Këtu mund të hyjnë jo vetëm linjat por edhe çdo infrastrukturë e cila mund të përmbajë infrastrukturën telekomunikuese si 'Huazimi i Shtyllave' ose 'Shërbimet e Ko-lokimit'.

### • Dark Fiber

Për klientët që kanë nevojë për disponim afatgjatë me kapacitete shumë të mëdha të "Bandwidth"-it dhe që preferojnë për të menaxhuar vetë "Bandwidth"-in, KOSTT gjithashtu ofron zgjidhje me "dark fiber" (fibra të errëta).

### • Shitja e kapaciteteve

KOSTT mund të shesë kapacitetet e pashfrytëzuara të veta për bartjen e të dhënave nga një pikë e rrjetit në një pikë tjetër.

Kjo formë e shërbimit, njihet ndryshe edhe me termin e lidhjeve 'Point to Point'.



### • Shërbimet e ko-lokacionit

Shërbimet e ko-lokacionit i përkasin grupit të "shërbimeve të Infrastrukturës", ku KOSTT-i mund të bashkëshfrytëzojë infrastrukturën e tij aktuale me operatorët e telekomit. Në këtë rast KOSTT-i mund ti huazoj (me qera) jo vetëm fibrat optik por edhe:

- Shtyllat e largëpërçuesve si ko-lokacion për antena,
- Hapsirat e nënstacioneve si ko-lokacion për pajisje.

### • Zhvillimi i shërbimeve të bazuara në ROADM ose IP/MPLS

Brenda tyre mund të futen shërbimet Lambda dhe/ose ato me vlerë të shtuar.


## Rrjeti fiber optik i KOSTT-it

Fibrat optike të instaluar në rrjetin e KOSTT-it janë kryesisht të vendosur brenda kablilit tokëzues të largëpërquesëve të tensionit të lartë, të njohur si OPGW, prandaj edhe rrjeti i fibrave optike njëkohësisht përcjellë rrjetin e linjave të transmisionit të energjisë elektrike.

Ky është një rrjet i avancuar fibër optik, me një gjatësi prej mbi 1100 km , i aftë të përmbushë kërkesat funksionale dhe operationale për Operim me Sistemin e Transmisionit të Energjisë dhe njëkohësisht të ofroj shërbime të komunikimeve elektronike në vendbanimet kryesore në gjithë territorin e Kosovës.

Rrjeti fiber optik i KOSTT-it është i ndërlidhur edhe me vendet fqinjë si me Shqipëri, Maqedoni, Mali zi & Sërbi me kablo optike OPGW, të cilat mund të veprojnë si ura optike, duke mundësuar komunikime elektronike ndërkombëtare.

Skema e rrjetit fiber optik të KOSTT-it është e paraqitur në vijim.



## Llojet e kablove optike

Kablilot me fibra optike të instaluar në rrjetin e KOSTT-it janë kryesisht të llojit OPGW, por në përdorim janë edhe llojet e kablove ADSS & UGC me 24, 48 & 96 fije optike. Këto kablo janë në përputhshmëri me rekomandimet ITU-T si vijon:

- NZ-DSF ITU-T G.655 & G.655D
- SMF ITU-T G.652

## Kontakti

**KOSTT sh.a.,**  
**Spektori i Telekomunikacionit,**  
**Rr. Isa Boletini nr. 39,**  
**10000 Prishtinë.**  
**Kosovë**

E-mail : [nagip.syla@kostt.com](mailto:nagip.syla@kostt.com)  
Telefon: 038 / 501 301 201  
Website: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)